

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 708 Prot.

Tiranë, më 04, 07 2016

VENDIM Nr. 66, datë 28.06.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, për Rishikimin e vendimit Nr. 43, datë 20.05.2016 të KKA Nr. 6, për "*Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Hadrianopolis"*", bashkëdrejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA), Prof. Roberto Perna (Universiteti Maçeratës),

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, për Rishikimin e vendimit Nr. 43, datë 20.05.2016 të KKA Nr. 6, për "*Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Hadrianopolis"*", bashkëdrejtues Prof. Dhimitër Çondi (IA), Prof. Roberto Perna (Universiteti Maçeratës), duke shfuqizuar pikën Nr. 2 të vendimit Nr. 43, datë 20.05.2016 të KKA.
2. Të kryhen dy sondazhe arkeologjike për verifikimin e stratigrafisë së teatrit në zonën e nekropolit.
3. Të lidhet marrëveshje ndërmjet palëve pjesmarrëse në këtë projekt për hartimin e një projekti restaurimi, i cili duhet të depozitohet pranë IMK, për vijimin e procedurës për miratimin e tij në KKR.
Të lidhet aktmarrëveshje me IMK e cila do të monitorojë zbatimin e projektit të restaurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al